



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës

Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

Nr.57/19
Datë:19.11.2019

Në mbështetje të nenit 23, neni 28, të Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Ligji për plotësim ndryshim i tij Nr. 04/L-226, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës në përbërje të: Valon Prestreshi - Kryetar, Ahmet Krasniqi - Zv. Kryetar, Fatime Haziri – Anëtar dhe Shaqir Morina Anëtar, Lidhur me kërkesën nga Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës, tutje Ref. AAC, “Për çështjen e konkurrencës se operatoreve të angazhuar në ofrimin e shërbimeve në tokë në Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës tutje ANP “Adem Jashari”, në mbledhjen e mbajtur me datën **19.11.2019** jep këtë:

MENDIM PROFESIONAL

- I. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, tutje ref.(Autoriteti), angazhohet për të gjitha format e parandalimit, kufizimit ose keqpërdorimit të konkurrencës (Abuzimit me Pozitën Dominuese, Marrëveshjeve të Ndaluar, Praktikave të Bashkërenduara dhe Realizimit të Përqendrimeve të Paligjshme) nga ndërmarrjet ekonomike private apo publike, por edhe nga kufizimet e shkaktuara nga **administrata shtetërore dhe entet rregullatorë** në territorin e Republikës së Kosovës ose jashtë saj, nëse këto veprime kanë efekte në Kosovë.
- II. Vlerësojme se, AAC-në dhe ANP-në, gjegjësisht koncesionari LIMAK, të zbatojë Rregullat e Kontratës së Koncesionit të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës, të rishikojnë pengesat lidhur me Shërbimet Tokësore, siç parashihet në Marrëveshjen e Koncesionimit.- Partneritetit Publiko Privat-PPP si në vijim:
 - a) *Kontrata e Partneritetit Publiko Privat respektivisht neni 9.1.16 (shërbimet tokësore),*
 - b) *Te jenë në pajtim me Ligjet dhe Rregulloret e Republikës së Kosovës,*
 - c) *Te jenë në pajtim me Direktivën 97/67/EC.*

- III. Autoriteti thekson se çdo kufizim ligjor apo faktik i numrit të operatorëve, të cilët janë potencial për t'u angazhuar në një veprimtari në një treg të caktuar (numerus clausus) në përgjithësi është e padëshirueshme nga pikëpamja e konkurrencës.
- IV. Autoriteti, vlerëson që operatorët të mos kufizohen nëpërmjet kushteve dhe kritereve diskriminuuese/përbjashtuese. Kufizimet e tilla mund të qojnë në favor të një operatori të veçantë duke i vendosur në pozita të pafavorshme konkurrenseve operatorët tjerë. Sigurimi i konkurrencës efikase do t'i mundësonte ndërmarrjeve të konkurrojnë me ofertën e tyre e cila në fund, do të jete në favor të shfrytëzuesve/përdoruesve përfundimtar të cilët do të jenë në gjendje të zgjedhin ofertën më të përshtatshme për produktet/shërbimet e operatorëve.
- V. Parimi themelor i ligjit dhe politikës së konkurrencës është të sigurojë qasje të lirë në treg për çdo ndërmarrje e cila i plotëson kushtet për të konkurruar në atë treg në interes të përdoruesve të shërbimeve dhe të mund të konkurrojnë me çmim dhe cilësi.
- VI. Autoriteti jep këtë mendim profesional duke e trajtuar kërkesën, bazuar në Ligjin dhe politikat e konkurrencës.

**KOMISIONI
AUTORITETI KOSOVAR I KONKURRENCËS**


Valon Prrestreshi
Kryetar


Ahmet Krasniqi
Zv. Kryetar


Fatime Haziri
Anëtare


Muhamed Krasniqi
Anëtar


Shaqir Morina
Anëtar

Me këtë Mendim Profesional të njoftohet:

- *Autoriteti i Aviacionit Civil*
- *Arkiva*